

Deklaratë për shtyp e Sekretares së Përgjithshme të RCC, Majlinda Bregu me rastin e nënshkrimit të Deklaratës së Roaming ndërmjet operatorëve të telekomunikacionit të BE-së dhe BP-së, më 6 dhjetor 2022 në Tiranë.

Zëvendëskryeministrja Balluku, Komisioneri Varhelyi, përfaqësues të operatorëve, media

Samiti i parë BE-BP në rajonin tonë, në qytetin tim të lindjes, Tiranë, është i rëndësishëm në shumë drejtime - duke përqafuar të gjitha të mirat që BE-ja ka për të ofruar dhe duke sjellë një erë të re në dinamikat e saj mes vendimmarrësve dhe atyre që i përcaktojnë këto vendime (decision shapers).

Meqenëse shoqëritë dhe njerëzit nuk mund të mbijetojnë pa një shkallë pritsshmërie dhe rregullimi (regulation), më vjen mirë që pas Berlinit dhe tre marrëveshjeve të lëvizshmërisë të nënshkruara atje, ne e nisëm ditën me një sukses më shumë drejt krijimit të Tregut të Përbashkët Rajonal të Ballkanit Perëndimor, dhe ky është nënshkrimi i Deklaratës së Roaming-ut e cila mundëson rregullimin e uljes së çmimeve të roaming ndërmjet rajonit tonë dhe BE-së.

Kjo ishte pyetja e parë që na u bë pasi Roam Like at Home hyri në fuqi në korrikun e 2021 – kur do të ulen çmimet e roaming me BE-në? Dhe kjo është gjëja e parë për të cilën kemi filluar të punojmë pas atij 1 korriku. Pra, ja ku është, çmimet e roaming-ut ndërmjet Ballkanit dhe BE-së do të ‘bien me gjethet’ vjeshtën e ardhshme.

Në terma praktikë, ky proces sfidues, bazuar në parimin e vetërregullimit dhe reduktimit vullnetar të çmimeve do të thotë që çdo operator telekomunikacioni i BP dhe BE, nënshkruar i Deklaratës, do të konsiderojë prezantimin e planeve dhe opsioneve me tarifa më të ulëta për përdoruesit e tyre në roaming në rrjetet e tjera celulare dhe ulja e parë e rëndësishme e çmimeve të roaming-ut për “data” do të hyjë në fuqi nga 1 tetori 2023. Ky është vetëm fillimi i procesit deri në arritjen e objektivit përfundimtar të çmimeve të roaming-ut në nivel të ngjashëm me atë vendas, në vitin 2027.

Ju mund ta keni vënë re këtë frazë "hyrje në faza në BE", në pothuajse të gjitha fjalimet e mia në vitet e kaluara. Dhe mund të keni pyetur veten se çfarë do të thotë. Kjo është ajo që do të thotë ‘hyrja në faza’. Ndërkohë që bëjmë çmos për t'u përgatitur për anëtarësimin në BE, është e nevojshme të integrohemi në faza me praktikatat dhe politikat e BE-së. Dhe ulja e çmimeve të roamingut në nivelin e çmimeve të brendshme është pjesë e saj.

Ulja e çmimeve të roaming-ut nuk është vetëm kursim parash, por do të thotë thjeshtim i lidhjes mes njerëzve, bizneseve, udhëtarëve, turistëve dhe në fund ‘mjegullim’ i kufijve.

Roam like at home në Ballkanin Perëndimor prezantoi disa ndryshime emocionuese. Sipas statistikave nga draft raporti i trafikut të të dhënave roaming, numri i përdoruesve të roaming në Ballkanin Perëndimor u rrit me 100%. Kur krahasojmë gjysmën e dytë të vitit 2021 me gjysmën e parë të atij viti, numri i minutave të kryera në thirrjet zanore dalëse u rritën deri në 237%, ndërsa thirrjet zanore hyrëse u rritën deri në 173%. Në të njëjtën kohë, vëllimi i trafikut të të dhënave u rrit deri në 459%. Këto janë shifra të jashtëzakonshme që shkojnë në favor jo vetëm të bashkëpunimit rajonal, por flasin shumë për një klimë më të mirë në rajon në



përgjithësi. Për sa i përket perspektivës ekonomike, sipas raportit të Bankës Botërore, rajoni vlerësohet të regjistrojë një rritje ekonomike prej 3.4% këtë vit.

Çdo arritje dhe rezultat nën axhendën e Tregut të Përbashkët Rajonal është një hap përpara drejt krijimit të një klime investimi mikpritëse që mund të tërheqë investime të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë.

Prandaj ulja e tarifave të roaming mes BE-së dhe rajonit tonë do të jetë një arritje e rëndësishme dhe ndryshimet që do të sjellë nuk do të jenë më pak të dukshme, jam e sigurt.

Në muajt e ardhshëm operatorët e telekomunikacionit do të duhet të hyjnë në negociata komerciale me njëri-tjetrin dhe të vendosin për modelet që do të përdorin, nëpërmjet të cilave do të zbatohen në praktikë reduktimet e cmimeve, p.sh., nëpërmjet zbritjeve, opsioneve speciale, paketave, ose planeve tarifore të reja ose të përditësuara, etj.

Nga ana tjetër, politikëbërësit në Ballkanin Perëndimor duhet të përshpejtojnë zbatimin e reformave të politikave në sektorin e telekomit jo më vonë se fundi i vitit 2023.

Negociatat për të arritur një marrëveshje nuk janë kurrë të lehta. Ndonjëherë janë dhëmbë dhe kthetra. Por kjo Deklaratë është rezultat i angazhimit të fortë të operatorëve të telekomunikacionit të BE-së dhe BP-së dhe mbështetjes së Komisionit Evropian, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, si dhe angazhimit të autoriteteve të rajonit që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes Rajonale të Roaming të Ballkanit Perëndimor, duke e bërë rajonin e BP të ketë shërbim roaming pa pagesë nga korriku 2021. Ky është testamenti i qartë i mbështetjes së vazhdueshme dhe të palëkundur të Bashkimit Evropian (BE) në integrimin politik, ekonomik dhe social të Ballkanit Perëndimor. Ftojme operatorë të tjerë të telekomunikacionit si nga BE ashtu edhe nga Ballkani Perëndimor t'i bashkohen nismës.

Shpresoj që fryma e ndezur dhe e gjallë e Tiranës time të përhapet pozitivisht mbi punën tonë të përbashkët në të ardhmen, pasi duhet të punojmë më shumë së bashku: si rajon, si familje evropiane dhe si komunitet ndërkombëtar.